



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA PËR EVROPËN  
DHE PUNËT E JASHTME

## **Bushati në Lituani: Hapja e negociatave sa më parë**

2018-02-06 14:32:00



Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, z. Ditmir Bushati, në kuadër të një turi rajonal në vendet Baltike, po zhvillon një vizitë në Lituani.

Gjatë takimit me Ministrin e Punëve të Jashtme të Republikës së Lituanisë, z. Linas LINKEVIČIUS, Ministri Bushati diskutoi për bashkëpunimin mes dy vendeve dhe rëndësinë e gjallërimit të bashkëpunimit ekonomik.

Ministrat i kushtuan vëmendje të veçantë procesit të integritit evropian, impaktit transformues që ka politika e zgjerimit në vendet e rajonit të Ballkanit, përfshirë sigurinë e tij. Ministri Bushati e njohu kolegun e tij me procesin e reformave në Shqipëri, me fokus reformën në drejtësi, dhe masat e ndërmarra nga Qeveria shqiptare në plotësimin e 5 prioritetëve kryesorë në procesin e integritit, me fokus hapjen e negociatave për anëtarësim. Ministri Linkevičius konfirmoi qëndrimin mbështetës të Lituanisë për një vendim pozitiv për hapjen e negociatave për anëtarësim të BE me Shqipërinë gjatë këtij viti.

Ministrat diskutuan mbi situatën në rajon. Ministri Linkevičius vlerësoi rolin konstruktiv të Shqipërisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor si faktor i qëndrueshëm stabiliteti dhe bashkëpunimi rajonal.

Gjithashtu, Ministri Bushati zhvilloi një takim me anëtarë të Komitetit për Punët e Jashtme, Komitetit për Çështjet Evropiane dhe anëtarë të Grupit për marrëdhëniet ndërparlamentare me Vendet e Ballkanit Perëndimor në Parlamentin lituanëz. Gjatë takimit, z. Bushati njohu deputetët lituanëzë me progresin e Shqipërisë në procesin e integritit evropian dhe pritshmëritë në këtë kontekst. Deputetët lituanëzë vlerësuan progresin në adresimin e prioritetëve kyçë, dhe ndanë mendimin për rëndësinë që ka Zgjerimi jo vetëm për zhvillimin e vendeve aspirante, por dhe për forcimin e sigurisë së Unionit në përgjithësi.